



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 2694

NR. VENDIMI 1929



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË

NR. 1559/2694 AKTI
VENDIMI

NR.1929

Dt.Rregj 28.05.2021/28.06.2021
Dt.28.06.2021

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë prej :

GJYQTAR : ARBEN MICKAJ

Asistuar nga sekretarja Merita Drishti, pas shqyrtimit në seancë gjyqësore me dyer të hapura, sot më datë **1559** akti me datë ardhje 28.05.2021 dhe me numër regjistrim të mëpasshëm **2694** Akti 28.06.2021, në ngarkim:

I PANDEHUR:

Kevin Bogdo, i biri i Avniut dhe Engjellushes, i datelindjes 24.12.1997, lindur ne Sarande dhe banues ne Tirane rruga “Gani Domi”, banese private prapra “Marketit te Ri”, kati 3-te, ap.2, me arsim te mesem, i padenuar me pare, beqar,me shtetesi dhe kombesi shqiptare. Mbrojtur kryesisht ne gjykim nga Av.Vjollca Pustina me nr.2025 license, anetare e Dhomes se Avokatise Tirane.

I AKUZUAR:

Per kryerjen e vepres penale te “**Prodhimi dhe shitja narkotikeve**”, parashikuar nga neni **283/1 i K.Penal**.

ME PREZENCËN:

E përfaqësuesit të Organit të Prokurorisë pranë kësaj gjykate, **Z.Arian Permeti**.

Gjykata me vendim ka konstatuar kryesisht juridiksionin dhe kompetencën e saj si lëndore ashtu edhe tokësore për të gjykuar këtë çështje penale, dhe në bazë të neneve 69, 74 e 76/1 të K.Pr.Penale ka vendosur gjykimin e saj.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në prani të prokurorit Arian Permeti, si dhe në prezencë të të pandehurit Kevin Bogdo dhe mbrojtësit të tij Av.Vjollca Pustina, gjykata dhe pasi shqyrtoi aktet dhe si dëgjoi akuzën si dhe të pandehurin sëbashku me mbrojtësin, të cilët në konkluzionet përfundimtare kërkuan respektivisht:

PROKURORI:

- Deklarimin fajtor te pandehurit **Kevin Bogdo** për veprën penale të ”**Prodhim dhe shitje e narkotikeve**” parashikuar nga neni 283/1 te K.Penal dhe denimin e tij me 5(pese) vjet burgim.
- Në bazë të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e 1/3 të dënimit të të pandehurit **Kevin Bogdo** duke e dënuar me 3 (tre) vite e 4(kater) muaj burgim.
- Në bazë të nenit 59 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim dhe vendosjen në kohë prove për një periudhë prej 2(dy) vjetësh si dhe detyrimin e të pandehurit që të mbaj kontakt me Shërbimin e Provës.
- Shpenzimet proceduriale ne ngarkim te te pandehurit.

AVOKATI:

- Aplikimin e nenit 59 të K.Penal dhe pezullimin e ekzekutimit të v endimit me burgim dhe vendosjen në kohë prove.

I PANDEHURI:

- Jam dakort me avokatin.

V Ë R E N:

Se nga Organi i Prokurorisë pranë kësaj gjykate, është sjellë për gjykim penale me Nr.1559 Akti, me datë ardhje 28.05.2021, në ngarkim të pandehurit Kevin Bogdo, akuzuar për veprën penale të “Prodhim dhe shitje të lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 283/1 të Kodit Penal.

Gjatë seancës paraprake të datës 28.06.2021, nga ana e të pandehurit, të asistuar nga mbrojtësi i tij, kanë kërkuar aplikimin e procedurave te rritit te gjykimit te shkurtuar, duke pranuar kryerjen e vepres penale si dhe njohur vleren e akteve, kerkese me te cilen ishte dakort edhe akuza.

Nga ana e Gjykatës në vleresimin qe u beri akteve te paraqitura nga Prokurori, ajo vendosi që gjykimi duhet zhvilluar në mbështetje të procedurave te parashikuara nga Nenet 403 - 406 te Kodit Proçedures Penale duke pranuar keshtu kerkesen e te pandehurit.

Nga shqyrtimi ne teresi i provave rezultoi se: Ne daten 27.02.2021 rreth ores 15.30,sherbimet e patrulles seforces se posacme "SHQIPONJA ", gjate patrullimit ne rrugen "Gramoz Pashka", kane ndaluar per kontroll automjetin me targe AA 964 LI qe drejtohej nga shtetasi Esmeraldo Shera. Pasagjer ne mjet ishin shtetasit Xhorxhino Vasili, Bleart Mucolli dhe i pandehuri Kevin Bogdo.

Gjate kontrollit fizik te ushtruar, te pandehurit Kevin Bogdo iu gjet ne pjesen poshte pantallonave nje qese e bardhe, brenda te ciles kishte 9 doza te dyshuara lende narkotike cannabis sativa, te mbeshtjella sejcila me leter alumini.

Nga policia gjyqsore eshte bere sekuestrimi i sendit te gjetur, lenda bimore e dyshuar si lende narkotike. Nga peshimi i proves materiale , rezultoi se sasia e dyshuar si lende narkotike cannabis sativa ishte 22.4 gram me gjith ambalazh, e cila pas peshimit eshte futur ne qesen e provave me nr unik A20003659 dhe u dergua ne Policine Shkencore per tju nenshtuar ekspertimit kimik te lendes.

Nga policia gjyqsore eshte mare moster urine:

- Te pandehurit Kevin Bogdo ne nje vazo plastike e cila eshte vendosur ne qesen e
- provave me nr serial A20000530
- shtetasit Xhorxhinjo Vasili vendosur ne qesen e provave me nr serial B20001655.
- shtetasit Esmeraldo Shera vendosur ne qesen e provave me nr serial B20001655
- shtetasit Bleart Mucollari vendosur ne qesen e provave me nr serial B20001655.

Mostrat e mare jane derguar per ekspertim toksikologjik.

Nga policia gjyqsore eshte bere kontrolli i baneses se pandehurit Kevin Bogdo, nga ku rezultoi se nuk jane gjetur sende te kundraligjshme.

Ne deklarimin e tij, i pandehuri Kevin Bogdo, deklaroi se eshte perdorues prej disa vjetesh i lendes narkotike. Lenden narkotike ja ka dhene nje shtetas te Qyteti Studenti.

Ne deklarimin e tyre shtetasit Esmeraldo Shera, Xhorxhino Vasili, Bleart Mucolli sqaroi ne se jane takuar dhe kane dale per te bere nje shetitje me makine. Mjetin e drejtonte shtetasi Esmeraldo Shera. Jane perdorues te lendeve narkotike . Diten qe jane ndaluar nuk kane pasur dijeni se shtetasi Kevin Bogdo kishte me vete lende narkotike. Gjithashtu shprehen se nuk kane asnje dijeni qe Kevin Bogdo te jete shites i lendeve narkotike.

Nga akti ekspertimit toksikologjik nr 594 date 24.03.2021, ka rezultuar se:

Ne mostren e urines mare shtetasit Kevin Bogdo ,mbyllur ne kontenjer dhe futur ne qese prove me nr A20000530, nuk u zbulua prania e produkteve kanabinodike te metabolizmit te bimes Cannabis Sativa L ne organizmin e njeriut.

Nga akti ekspertimit kimik nr 4000 date 30.04.2021, ka rezultuar se:

Materialet bimore objekt ekspertimi jane cannabis produkt herbal bime cannabis sativa L.

Pesha totale pa ambalazh e materialeve bimore objekt ekspertimi eshte 11 grame.

Me date 27.05.2021 organi i akuzës ka vendosur te dergoje çështjen per gjykim në ngarkim të të pandehurit Kevin Bogdo me akuzën e « Prodhim e shitje të lëndëve narkotike » të parashikuar nga neni 283/1 të K.Penal.

Ne perfundim te hetimit gjyqësor gjykata krijon bindjen se i pandehuri Kevin Bogdo duhet te deklarohet fajtor per veprën penale të “Prodhimit e shitjes së lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 283/1 të K.penal.

Gjykata çmon se, drejt ka vepruar organi i prokurorisë në përcaktimin e kualifikimit ligjor të veprave penale ndaj të pandehurit Kevin Bogdo.

Përsa më sipër i pandehuri Kevin Bogdo, ka konsumuar vepren penale “Prodhim e shitje të lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 283/1 të Kodit Penal.

Akuza ndaj te pandehurit Kevin Bogdo, u provua dhe nga administrimi në seancë gjyqësore të provave shkresore:

- Procesverbal I kapjes ne flagrance date 27.02.2021.
- Raport Shërbimi date 27.02.2021.
- Procesverbal i kontrollit te vendeve date 27.02.2021.
- Procesverbal i sekuestrimit te proves materiale date 27.02.2021.
- Procesverbal I peshimit te proves materiale, date 27.02.2021.
- Procesverbal I marrjes se mostres se urines, date 27.02.2021.

- Akt ekspertimit toksikologjik nr.594 date 03.03.2021
- Akt ekspertimi kimik nr 4000 date 30.04.2021.
- Procesverbal deklarime te shtetasve Xhorxhino Vasili, Esmeraldo Shero, Bleart Mocollari.
- Si dhe ne teresi aktet e fashikullit hetimor me nr.1500 viti 2021 i Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Tirane.

Në këto rrethana, e ndodhur përpara këtyre parashtrimeve, percaktimit te faktit dhe provave në gjykim, **Gjykata çmon se veprimet e të pandehurit Kevin Bogdo, plotesojne të gjithë elementet që kërkon legjislacioni penal shqiptar, për t'i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikeve”, ne formen e mbatjes,të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal i Republikës se Shqiperise.**

Në lidhje me nenin 283/1 të K.Penal:*Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet.*

Objekti i kësaj vepre penale është mbrojtja e marrëdhënieve juridike të vendosura për të garantuar rendin dhe sigurinë publike nga veprimet ose mosveprimet kriminale. Konkretisht veprimet e kundraligjshme të kryera nga i pandehuri Kevin Bogdo, kanë cënuar marrëdhëniet juridike të vendosura me Ligjin Nr.7975, date 26.07.1995 **“Për barnat narkotike dhe psikotrope”**, për të siguruar rendin dhe sigurinë publike, veçanërisht jetën dhe shëndetin e personit, regjimin juridik për shitjen, dhënien, marrjen dhe mbajtjen e substancave narkotike dhe psikotrope, të mbrojtura me legjislacionin tonë penal nga veprimet apo mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive kjo vepër penale është konsumuar nga i pandehuri Kevin Bogdo, dhe se veprimet e kunderligjshme jane manifestuar ne formen e mbajtjes, nisur nga fakti se gjatë kontrollit fizik të ushtruar ndaj tij nga ana e efektivëve të policisë janë gjetur 9 doza në masën e përgjithshme prej 11 gram.

Ana subjektive e veprës penale realizohet me dashje direkte. I pandehuri nga tërësia e rrethanave të faktit dhe objektit të marrëdhënies juridike nuk mund të mos pranohet dijenia që veprimet e tij bien ndesh me urdhëresat e ligjit. Ai ka parashikuar që me veprimet e tij konsumon elementët e një vepre penale.

Subjekti i kësaj veprës penale duhet të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale për krime dhe duhet të mos ekzistojnë shkaqe për përjashtim nga përgjegjësia penale të të pandehurit. Nga tërësia e akteve rezulton se i pandehuri gjenden si subjekt i veprës penale.

Në caktimin e llojit dhe masën e dënimit gjykata duhet të ketë parasysh këto rrethana të vërtetuara gjatë gjykimit.

- Rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale të “Prodhim e shitje të lëndëve narkotike”, për të cilën ligjëvënësi ka parashikuar një masë dënimi nga pesë vjet deri

në dhjetë vjet burgim.

- Faktin që i pandehuri nuk ka qënë penalisht i dënuar më parë.
- Faktin që sipas akteve të ekspertimit, i pandehuri është përdorues i lëndëve narkotike.

Referuar, analizës juridike si me sipër, Gjykata vlereson se për shkak të bindjes së saj të krijuar mbi provat e administruara në gjykim mbi implikueshmërinë e plote të të pandehurit **Kevin Bogdo**, në veprimtarinë e kundërligjshme të lidhur me mbajtjen e lëndës narkotike të sekuestruar, të analizuar më sipër, në rastin konkret vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri, është kualifikuar drejt nga organi i akuzës sipas cilesimit të duhur juridik, të konkluduar nga konsumimi plotësisht prej të pandehurit i të gjithë elementeve të figures së veprës penale, të parashikuara nga neni 283/1 i K.Penal.

Gjithashtu Gjykata çmon se, ky dënim do t'i shërbejë edukimit të të pandehurit, parandalimit të kryerjes së veprave penale nga i pandehuri, si dhe parandalimit të përgjithshëm të këtyre veprave penale në shoqëri.

Duke qënë se, i pandehuri Kevin Bogdo u deklaruan fajtor gjatë këtij gjykimi, për veprën penale për të cilën u akuzua, bazuar në nenin 485 të Kodit Procedures Penale, i pandehuri detyrohet të paguaj shpenzimet e parapaguara nga shteti, si gjatë fazës së hetimeve paraprake në shumën ashtu dhe shpenzimet gjyqësore.

PËR KËTO ARSYE:

**Gjykata bazuar në nenet: 47, 48, 49, 51, 59, 283/1 të K.Penal,
190, 217, 380, 381, 382, 383, 384, 390, 393,
403-406 të K.Pr.Penale:**

V E N D O S I

- Deklarimin fajtor të pandehurit **Kevin Avni Bogdo** për veprën penale të "**Prodhim dhe shitje e narkotikeve**" parashikuar nga neni 283/1 të K.Penal dhe dënimin e tij me 5(pese) vjet burgim.
- Në bazë të nenit 406 të K.Pr.Penale, uljen e 1/3 të dënimit të të pandehurit **Kevin Avni Bogdo** duke e dënuar me 3 (tre) vite e 4(kater) muaj burgim.
- Në bazë të nenit 59 të K.Penal, pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim dhe vendosjen në kohë prove për një periudhë prej 2(dy) vjetësh si dhe detyrimin e të pandehurit që të mbaj kontakt me Shërbimin e Provës.
- Shuarjen e masës së sigurimit "Arrest në shtëpi" të dhene me vendimin me nr.352 akti, date 02.03.2021 të Gjykates së Rrethit Gjyqësor Tirane.
- Shpenzimet proceduriale në ngarkim të të pandehurit.
- Kunder vendimit mund të behet ankim nga palet brenda 15 diteve në Gjykatën e Apelit Tirane, duke filluar ky afat nga e nesërmeja e komunikimit të këtij vendimi.
- **U shpall në Tirane sot me date 28.06.2021.**

SEKRETARE

G J Y Q T A R

**MERITA DRISHTI
MICKAJ**

ARBEN

**Shpenzimet hetimore
12000 leke**

Shpenzime gjyqesore

Njoftime 1x150 leke

Avokate 5000 leke